



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 29, datë 21.01.2020

PËR GJYQTARËT E GJYKATAVE ME JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM TË CAKTUAR NË ÇËSHTJE TË VEÇANTA NË GJYKATAT E POSAÇME PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 4, pika 3, nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në Vendimin e tij nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, duke patur në konsideratë Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr.7/2011 dhe dispozitat e Kreut IV, të Titullit V, të Kodit të Procedurës Penale, mbi kërkesat respektive të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

- I. Gjyqtarët e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, të caktuar më herët nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, vazhdojnë të shqyrtojnë çdo kërkesë procedurale që lidhet me te drejtat dhe liritë themelore të të pandehurit/eve, në çështjet e veçanta në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, si më poshtë:
 1. Gjyqtarët Erjon Bani dhe Ardian Kalia, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale kundër të padehurit {...}, i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 284/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).
 2. Gjyqtarët Shefkije Demiraj dhe Kreshnik Omari, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale kundër të padehurit {...}, i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 333/a, paragrafi i parë, 283/a, paragrafi i parë dhe 334, paragrafi i parë, të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).
 3. Gjyqtari Erjon Bani, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale kundër të padehurit {...}, i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a/1-22, 28/4,

333/a/2, 334/1, 278/2 dhe 280 të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).

4. Gjyqtarët Ardian Kalia, Erjon Bani dhe Artan Gjermëni, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale kundër të padehurve {...} dhe {...}, të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).
5. Gjyqtari Ardian Kalia, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale kundër të padehurve {...}, etj, të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a/1-22, 28/4, 333/a/2, 334/1, 278/2 dhe 280 të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).
6. Gjyqtari Sokol Tona, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale kundër të padehurit {...}, i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).
7. Gjyqtarët Etleva Temo dhe Artur Kalaja, respektivisht të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë, në çështjen penale kundër të padehurve {...} etj, të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 109/b/1 dhe 28/4, 238 dhe 28/4, 152/1, 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda).
8. Gjyqtarët Genti Shala, Valdete Hoxha dhe Asim Vokshi, të Gjykatës së Apelit Tiranë, në çështjen penale kundër të padehurit {...}, i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 109/b/1, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda).

II. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarëve dhe gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR